



### Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-118370/22 dt. 27.05.2022, në emër të aplikuesit Shaip Stublla nga Podujevë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës afariste – me etazhitet B+P+2, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban- PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 32-2 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 06.06.2022 deri më 20.06.2022, në e-mail adresën: [urbanizimprištine@rks-gov.net](mailto:urbanizimprištine@rks-gov.net).

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesë afariste, me etazhitet B+P+2
b. Vija rregulluese	Rruga sipas Planit Zhvillimor Urban
c. Vija ndërtimore c1. Ruga Publike c2. Anët – djathtas (AD) c3. Anët – majtas (AM) c4. Pasmë	18.84 m' nga rruga e planifikuar sipas PZHU AM. 0.5 h / 1.21 m' - 1.47 m' AD. 0.5 h / 3.75 m' - 5.26 m' P. 0.5 h / 14.29 m' - 19.92 m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike.	~10.00 m' vija ndërtimore sipas "PZHU"
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	AD. 1.21 m / kufiri i parcelës kadastrale fqinje është 0.5H AM.3.75 m / kufiri i parcelës kadastrale fqinje është 0.5H P. 1.429 m/ kufiri i parcelës kadastrale fqinje është 0.5H
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40 % e lejuar sipas PZHU-së/ ~ 39.996 % e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40 % e lejuar sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 dt 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës ~ 43.32 % e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60 % e lejuar sipas PZHU-së/ ~ 39.62 % e propozuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	4-VP / 100 m <sup>2</sup> për afarizëm. 1-VP / 100 m <sup>2</sup> për depo.
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin e këtij njoftimi publik.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

